



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA E KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 20/OPK
Nr. i llog. 02
Broj stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 01-558/16
B. Prot. Prot. No.
Data 10-02-2016
Date

PRISTINE

DATË/A:	10/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/526/16
PËR/ZA/TO:	z. Hasim KRASNIQI Drejtor i Prokurimit – Posta e Kosovës
CC:	z. Sejdi HOXHIA Krye Shef Ekzekutiv – Posta e Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Furnizim me material shpenzues dhe mjete pune për mirëmbajtjen teknike të objekteve”

I nderuar z. KRASNIQI

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me material shpenzues dhe mjete pune për mirëmbajtjen teknike të objekteve” me numër prokurimi: PK/16/006/136, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull “Furnizim me material shpenzues dhe mjete pune për mirëmbajtjen teknike të objekteve” me numër prokurimi: PK/16/006/136, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit pranë Postës së Kosovës ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzues dhe mjete pune për mirëmbajtjen teknike të objekteve" me numër prokurimi: PK/16/006/136, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 02/02/2016. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën kuotim çmimi për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në një kriter që është në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, në tabelën

Lot 1: Furnizim me material shpenzues për ndërtimtari dhe hidrosanitari, pika 5 kërkohet "BRAVA AGB PËR DRU, 6 cm (C), 8 cm (TH) DHE BRAVA STANDARTE GJERMANE"

Me këtë kërkesë ju si Autoritet Kontraktues në Dosjen e Tenderit keni paracaktuar vendin e origjinës për pajisjen furnizuese. Me këtë veprim, favorizoni operator të caktuar ekonomik dhe në të njëjtën diskriminoni të tjerë. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Tutje, autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi ; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !